

VENDIM
Nr. 241, datë 20.4.2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE QË NDIQEN PËR PROKURIMET E BËRA NË NJË VEND TË TRETË, PËRFSHIRË PROKURIMET CIVILE TË KRYERA KUR FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË JANË DISLOKUAR JASHTË TERRITORIT TË VENDIT DHE KUR, PËR NEVOJA OPERACIONALE, DUHET TË LIDHEN KONTRATA ME OPERATORËT EKONOMIKË, QË JANË NË VENDIN KU PO KRYHET OPERACIONI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “ç”, dhe 2, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e procedurave, që ndiqen për prokurimet e bëra në një vend të tretë, përfshirë prokurimet civile të kryera, kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit dhe kur, për nevoja operationale, duhet të lidhen kontrata me operatorët ekonomikë, që janë në vendin ku po kryhet operacioni.

2. Qëllimi i këtij vendimi është plotësimi i nevojave operationale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në rastet e dislokimit jashtë vendit dhe kur është i pamundur krijimi i strukturave përgjegjëse të procesit të prokurimit e kryerja e procedurave standarde të blerjes së mallit/shërbimit/punës.

3. Ky vendim zbatohet për blerjen e të gjitha shërbimeve/mallrave/punëve për plotësimin e nevojave operationale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të dislokuara jashtë territorit të vendit dhe që janë të paparashikuara në marrëveshjen teknike të nënshkruar ndërmjet shtetit pritës, shtetit udhëheqës të misionit dhe/ose shteteve pjesëmarrëse në të ose kur, për shkaqe specifike të misionit, nuk zbatohet marrëveshja teknike.

4. Ky vendim nuk zbatohet për blerjen e armatimit, të municioneve dhe të pajisjeve të tjera speciale të ushtarakut.

5. Në zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

5.1 “Marrëveshje teknike”, marrëveshja e nënshkruar ndërmjet shtetit pritës, shtetit udhëheqës të misionit ose stërvitjes ushtarake dhe/ose shteteve pjesëmarrëse në të, e cila dakordëson për të drejtat e detyrimet e palëve, përpara fillimit të misionit ose të stërvitjes ushtarake.

5.2 “Nevoja operationale”, situatat urgjente dhe jourgjente (që nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operationalitet), plotësimi i të cilave nuk cenon në kohë, burime dhe në kapacitete realizimin e misionit.

5.3 “Personi përgjegjës për kryerjen e blerjes”, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose stërvitje ushtarake jashtë vendit, sipas përcaktimeve të urdhrat të ministrit përgjegjës për mbrojtjen, për dërgimin e personelit në mision ose në stërvitje ushtarake.

5.4 “Struktura përgjegjëse eprorë”, struktura përgjegjëse, në varësi të së cilës është personeli, që dërgohet në mision apo në stërvitje ushtarake.

5.5 “Shkaqe specifike të misionit”, rastet kur ushtarakët ndodhen në mes të një konflikti të armatosur dhe paraqitet një nevojë urgjente për furnizim me mall/shërbim a punë, e cila nuk pret deri në kthimin në bazën ushtarake përkatëse.

KREU II

PROCEDURAT E BLERJEVE TË SHËRBIMEVE/MALLRAVE/PUNËVE

1. Për realizimin e misionit ose të stërvitjes, për blerjen e shërbimeve/mallrave/punëve, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose stërvitje ushtarake jashtë vendit, për shkak të nevojës urgjente për furnizim, kryen blerjen e shërbimeve/mallrave/punëve, duke përzgjedhur vetë operatorin/ët ekonomikë dhe negocion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre. Në këtë rast, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit negocion me ofertuesin/t, me qëllim përshtatjen e ofertave të tyre me kërkesat për realizimin e misionit ose stërvitjes.

1.1 Drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit harton e ruan, në përputhje me legjislacionin tatimor të vendit ku kryhet operacioni, dokumentacionin vërtetues për kryerjen e blerjes, që është: kontrata (aty ku është e mundur), fatura elektronike (aty ku është e mundur)/fatura e shitjes, fletëhyrja e mandatpagesa dhe, në momentin e kthimit në atdhe, e paraqet atë pranë njësisë ushtarake përgjegjëse.

1.2 Për blerjen e këtyre shërbimeve/mallrave/punëve, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak njofton, nëpërmjet komunikimit elektronik, autoritetet e komandim-kontrollit, sipas hierarkisë.

1.3 Në çdo rast, aktivet merren në administrim nga komandanti i kontingjentit, drejtuesi/përfaqësuesi i misionit ose i stërvitjes.

2. Për blerjen e shërbimeve/mallrave/punëve, të cilat nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operacionalitetin për realizimin e misionit ose të stërvitjes dhe për të cilat kërkohet asistencë, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose stërvitje ushtarake jashtë vendit, paraqet, nëpërmjet komunikimit elektronik, kërkesën për blerje pranë strukturës përgjegjëse eprore, sipas hierarkisë, e cila, jo më shumë se 5 (pesë) ditë pune nga e nesërmja e ditës së marrjes së saj, kthen përgjigje për miratimin apo refuzimin e kërkesës.

2.1 Pas miratimit të kërkesës për blerje nga struktura përgjegjëse eprore, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit, do të ndjekë të njëjtën procedurë dhe do të hartojë të njëjtin dokumentacion, siç parashikohet në pikën 1, të këtij kreu.

3. Struktura përgjegjëse eprore, si dhe strukturat e tjera zbatuese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin dhe auditin financiar të veprimtarisë së organeve shtetërore kryejnë kontrole financiare për procedurat e blerjes, objekt i këtij vendimi, referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë saj nga drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama